

Tendenca të reja në artet pamore të Kosovës

Nga narracioni në konceptualizëm

Shyqri Nimani

Përmbledhje

Artin modern e sollën në Kosovë gjatë viteve 1960-1970 brezat e parë të krijuesve shqiptarë, të cilët u diplomuan në akademitë e arteve të qendrave kryesore artistike të ish-Jugosllavisë - Lubjanë, Zagreb dhe Beograd. Këta krijues do të hyjnë në histori si pionierë të artit modern kosovar. Disa nga këta artistë tentuan të zhvillonin stile dhe doktrina autentike. Disa të tjerë, ndërkaq, që nuk arritën të shmangnin ndikimet e pedagogëve të tyre, mbetën fatkeqësisht nën ndikimet *bejkëniiane* apo *shagaliane*. **Përfaqësuesit më karakteristikë në pikturë**, janë:

Nysret Salihamixhiqi, Muslim Mulliqi, Xhevdet Xhafa, Engjëll Berisha, Adem Kastratit, Esat Valla;

në *skulpturë*: **Agim Çavdarbasha dhe Agim Rudi;**

në *grafikë*: **Gjelosh Gjokaj, Fatmir Krypa, Agim Salihu dhe Ymer Shaqiri;**

në *artet e aplikuara*: **Agush Beqiri Nuredin Loxha Simon Shiroka, Shyqri Nimani dhe Violeta Xhaferi.**

Pas viteve 1970, u shfaq *new media art* si kategori më vete. Togfjalëshi arti bashkëkohor (*contemporary art*) i referohet në përgjithësi artit që krijohet tani (*art being done now*). Karakteristikë e posaçme e artit bashkëkohor janë çështjet që shpeshherë trajtohen nën ndikimin e koncepteve që paraqesin në botën e sotme termat si p.sh. *klonimi, politika, ekonomia, seksualiteti, racat, etnitetet, të drejtat e njeriut, lufta, varfëria* etj. me një impenjim të veçantë në *performanca, instilacione* dhe *video*, duke tejkalluar kështu tërësisht kufijtë konvencionalë.

Fjalët kyç: artet pamore, pikturë, skulpturë, grafikë, artet e aplikuara, trende inovative, video art, media art, modernizëm, arti bashkëkohor, surealizëm, fovizëm, kubizëm, ekspresionizëm, futurizëm, arti konceptual, performancë, kollazhim, instilacion, freskografi, ikonografi, akuatintë, mexotintë, bakërshkrim, akuarel.